Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Burim Zeka	**13.06.2023**	**21.06.2023**	**2023/0377**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 09.06.2023, OE **"Dyqani i Pavarur Tregtar Autopjesë "Buqa""-** Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/377, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë **OE "IDEAL SHALA B.I"- Parku i Biznesit Drenas,** lidhur me aktivitetin e prokurimit**: "Furnizim me pjese për automjetet Shkoda Rapid –te"** me nr. të prokurimit: **"214-23-1137-1-1-1"**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues **(AK) – POLICIA E KOSOVËS**.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: Kontrate Publike Kornizë me një Operator Ekonomik, furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: **550,000.00 €.**

Fazat e procedurës se prokurimit:

Njoftimi për kontratë.....02.03.2023;

Procesverbali i hapjes së ofertave.....20.03.2023;

Njoftimi mbi vendimin e AK-së.....22.05.2023;

Kërkesa për rishqyrtim 29.05.2023;

Vendimi i AK-së në kërkesë për rishqyrtim.....02.06.2023;

Ankesa ne OSHP.....07.06.2023;

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

- Neni 1 (LPP),

- **Neni 7 (LPP),**

- **Neni 51 (LPP),**

- **Neni 59 (LPP),**

- **Neni 60 (LPP),**

- Neni 72 (LPP)

Të nderuar me dt. 22.05.2023 përmes platformës elektronike e-prokurimit kemi pranuar njoftim mbi vendimin e AK-së ku e ka rekomanduar për kontratë OE "Ideal Shala"B.I , ju sqarojmë se OE i rekomanduar për kontratë është i pa përgjegjshëm për arsyer si ne vijim:

AK ka ber shkelje te nenit 1 te ligjit duke mos arritur ti përdor ne mënyrë te drejt dhe transparente fondet publike qe kane për qellim blerjen e furnizime nga një OE i cili nuk është i përgjegjshëm ne aspektin administrativ, pra nuk ka arritur ti përdor fondet për qëllimin e synuar duke rekomanduar për kontratë një OE i cili është i papërgjegjshëm.

AK ka ber shkelje te nenit 7 duke mos i trajtuar te gjithë OE ne pajtim me ligjin e kjo si pasoje duke synuar qe te shpërblejnë me kontratë një OE i cili nuk është ne pajtim me kushtet dhe kriteret e përcaktuara nga ana e vet AK pra ne rastin konkret ka ber vlerësim ne kundërshtim me kriteret e përcaktuara nga ana e vet AK për kualifikim dhe shpërblimin nga ana e AK, OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm ne aspektin administrativ dhe teknik.

AK ka ber shkelje te nenit 51 duke mos i respektuar vet kriteret kualifikuese te cilat i ka përcaktuar ne tenderin ne fjale pasi ka përcaktuar njërin nder kriteret kualifikuese është kontrata te realizuara përfunduara me sukses jo me pak se ne vlere prej 400,000 euro, e ketë kriter OE i rekomanduar nuk e ka përmbushur ne ketë aspekt pasi nuk ka kontrata te realizuara përfunduara gjate tri viteve te fundit.

AK ka ber shkelje te nenit 59 ku ne rastin konkret komisioni i vlerësimit nuk ka arritur te beje Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve ne pajtim te plot me ligjin dhe kriteret e përcaktuara nga vet AK ne rastin konkret AK e konsideron te përgjegjshëm një OE i cili nuk i plotëson kriteret kualifikuese për kontratat e realizuara përfunduara ne vlerën e kërkuara nga ana e AK ku kriteri kualifikues i AK është "Operatori ekonomik duhet te ofroj dëshmi se ka përfunduar kontrata të natyrës së njëjtë apo të ngjashme gjate 3 viteve te fundit (nga data e publikimit të njoftimit për kontratë) jo me pak se 400,000.00 €

I njëjti OE nuk e plotëson Kërkesën e lartcekur të dosjes së tenderit për faktin se nuk ka ofruar

dëshmi të mjaftueshme se i njëjti ka përfunduar projekte të natyrës së kontratës se në tri vitet e shkuara në vlerën e kërkuar 400,000.00 € si dhe flet dorzimet e mallit që janë ngarkur në sistem si dëshmi për kryerjenë e shërbimeve nuk janë konform kërkesës së AK-së janë të mangeta pasi që nuk ka as nr. të prokurimit e as emer të kontratës e as vleren e kontratës siq është kërkuar në dosjen e tenderit

Kur analizohet dokumentacioni i OE të rekomanduar për kontratë, të cilat i ka prezantuar me ofertë shihet se i njëjti nuk e plotëson kërkesën e AK-së pasi qëne listën e kontratave ka prezantuar kontrata që nuk janënjëjta apo te ngjashme me qëllimin e vet aktivitetit te prokurimit qe ka beje vetme me pjese rezerve për automjete, në listën e kontratave te prezantuar nga OE i rekomanduar ka kontrata dhe referenca që nuk janë te natyrës se njejt apo te ngjashme me këtë tender

Ne vijim paraqesim kontrata nga lista e te cilat AK nuk është dashur ti pranoje pasi nuk jane te njëjta e as te ngjashme:

Furnizim me Goma "European Union Of Law Mission in Kosovo" Vlera 70,000.00 Euro

Furnizim Vetura me Qera "Arkos" L.L.C Vlera 9,930.00 Euro

Funizim me goma per "KMDK" Vlera 38,362.64 Euro

Furnizim vetura me qera "KEDS" Vlera 3,000.00 Euro

Furnizim me nje automjet per nevojat e "KMDK"se Vlera 29,900.00 Euro

Furnizim me goma "Kost Invest" Vlera 887.00 Euro

Furnizim me goma "European Union Of Law Mission in Kosovo" Vlera 95,000.00 Euro

Furnizim me akumlator "Komuna Ranilug" Vlera 1,345.57 Euro

Furnizim me goma dhe bateri "Trepqa" 8,848.14 Euro

Furnizim me material dhe pasije per mirembajtjen e automekanizmit dhe sherbime shtes"KMDK" Vlera 10,508.80 Euro

Furnizimi dhe montimi me Goma per autoambulanc "Spitali i mitrovices" Vlera 2,158.50 E

Furnizimi me goma per Automjete "KK.Mitrovica Veriore" Vlera 3,00.00 Euro

Furnizim me goma "Komuna Zveqan" Vlera 2,449.46 Euro

Furnizim me bateri 12v-180 AH "KEK" 2,600.48 Euro

Furnizim me goma "KK. Mitrovica Jugore" Vlera 2,712.43 Euro

Furnizim me trotinet elektrik "KEDS" 4,774.00 Euro

Furnizim me bateri "Ministria e Mbrojtjes" Vlera 78,340.14 Euro

Asnjëra nga këto referenca te këtij lloji nuk mund të llogariten për këtë aktivitet të prokurimit pasi që nuk janë të natyrës se njëjtë apo të ngjashme me qëllimin e aktivitetit të prokurimit pasi qëllimi i aktivitetit te prokurimit ka qen furnizimi me pjese rezerve.

Po ashtu OE ka prezantuara kontrata me kompani private ku sipas kontratave të bashkangjitura janë aktive dhe nuk mundë të pranohen e kjo është e definuar ne ligj se kontratat aktive nuk mundë të pranohen pasi nuk të janë të përfunduara, në vijim paraqesim kontratat e prezantuara e te cilat janë aktive:

"GOLDEN TAXI"SH.P.K Vlera 25,600.00 Euro Aktive deri me 04.02.2024

"TIMO CONSTRUCTION"SH.P.K Vlera 33,600.00 Euro Aktive deri me 05.02.2024

"BURAK"SH.P.K Vlera 39,713.71 Euro Aktive deri me 10.02.2024

N.T.P"MICHELIN-1" Vlera 24,782.00 Euro Aktive deri me 15.02.2024

"KASTRATI"SH.P.K Vlera 54,000.00 Euro Aktive deri me 03.03.2024

D.P.T AUTOPJESE "BUQA" Vlera 133,725.80 Euro Aktive deri me 03.03.2024

"LISI G"SH.P.K Vlera 27,000.00 Euro Aktive deri me 07.04.2024

"CITY TAXI O.P" Vlera 55,949.00 Euro Aktive deri me 01.07.2025

"AUTO GAMA"SH.P.K Vlera 12,550.00 Euro Aktive deri me 03.08.2024

"AUTO JAPAN" SH.P.K Vlera 16,557.41 Aktive deri me 06.01.2026

AUTO PJESE "FLORENTI" Vlera 6,274.00 Euro Aktive deri me 10.01.2026

"KMDK" Vlera 400,202.00 Euro Aktive

Duke i eliminuar kontratë e larte shënuara atëherë kontrata qe OE i ka prezantuara e te cilat janë te realizuara përfunduara me sukses janë ne vlere vetëm prej **111,731.85**euro pasi qe OE ka deklaruar edhe fatura edhe me data pas hapjes se aktiviteti te prokurimit si dhe me shërbime qe nuk i përkasin kësaj lamie, si psh. Saldim, bateria, gypa hidraulik, riparim i gypave etj, si dhe ne listën e kontratave ka pasur disa kontratat qe te pa specifikuara se për kënd janë kryer ato shërbim nuk ka prezantuar as kontrata e as fatura e as referenca, OE i rekomanduar për kontratë nuk ka plotëson kushtin e AK për kontrata te realizuara ne vlere prej **400,000.00** euro.

	A	B	C	D	E
1	NR	Titulli i kontratës	Data e nënshkrimit te kontrates	Vlera totale e kontrates	Emri i Blerësit
2	2	Furnizim me pjese rezerve per makineri Liebherr	24.04.2019	€ 29'263.20	Kompania per Menaxhimin e Deponive ne Kosove Sh.A
3	3	Furnizim pjese per Automjete	13.05.2019	10,943.02	European Union of Law Mission in Kosovo
4	4	Furnizim me Pjese rezerve per makineri e rend Buldozher	29.07.2019	€ 56'799.44	Kompania per Menaxhimin e Deponive ne Kosove Sh.A
5	10	Furnizim me gjese dhe vaje motorik	10.08.2000	€ 7'177.51	Telekomi
6	11	Furnizim me gjese per automjete Toyota L30	23.05.2020	€ 5'799.97	Policia e Kosovës
7	31	Furnizim me pjese kembimi per automjete	04.11.2021	€ 9'282.05	Telekomi
8	45	Furnizim me gjese per Nissan Terrano	19.12.2022	€ 3'519.17	Telekomi i Kosovës Sh.A
9					

Si ka mundësi një OE te cilin vetë ky AK e eliminon për kontrata te realizuar për dy aktivitet te prokurimit ku vlera e kontratave të realizuara jenë më të vogla atëherë lind pyetja si ka mundësi në këtë aktivitet të jetë në rregull, aktivitet e prokurimit për të cilat ky OE janë eliminuar janë si në vijim:

Furnizimi me pjese per automjetet Toyota Land Cruser 150 (Referenca e Kerkuar 200,000.00 Euro) me numer te prokurimt 214-23-1737-1-1-1

Furnizim dhe montimi me pjese rezerv per automjetet Skoda Octavia-Ritender (Referenc e Kerkuar 300,000.00 Euro) me numer te prokurimt 214-23-4-1-1-1

Andaj këtu shihet qartë së komisioni në këtë rastë nuk e ka vlersuar si duhet këtë aktivitet të prokurimit pasi që ne dy aktivitet e lartë cekura është kërkuar shumë me pak referenca dhe OE i rekomanduar për kontrat nuk e ka ka përmbushur këtë kriter, e si është e mundur në këtë rast ta plotesoj kushtin prej 400,000.00 Euro referenca.

-OE i rekomanduar për kontratë është i pa përgjegjshëm edhe për faktin se i njëjti është munduar të manipuloj me produktet me te cilat ka ofertuar. Kur analizohet lista e përshkrimit te çmimeve e OE të rekomanduar për kontratë vërtetohet një fakt i tillë, mirëpo ne po ju dëshmojmë edhe një herë një gjë të tillë, duke e sqaruar konkretisht pretendimin tonë ankimor.

Tek lista e përshkrimit te çmimeve ku është kërkuar Emri i Prodhuesit dhe Origjina operatori i rekomanduar për kontrate ka ofertuar ne ketëmënyrë:

a. Tek Pozicioni **147, 148 Krahu i mram LH, RH** ka vendosur si prodhues BLIC/EU e cila nuk

e prodhon këtë produkt

b. Tek Pozicioni **132 Komanda e Alarmit Komplet CJB-FS 880** ka vendosur si prodhues

OE VW/EU e cila nuk e prodhon këtë produkt.

- Përderisa OE i rekomanduar për kontrate ka vendosur ne listën e përshkrimit te çmimeve

prodhues te cilët nuk prodhojnë produktet e larte cekura, kuptohet çart se i njëjti OE është i pa

përgjegjshëm dhe si e tillë është dashur të konsiderohet edhe nga ana e AK-së mirëpo që një veprim nuk e ka bere duke e favorizuar OE te rekomanduar përkontratë.

OE i rekomanduar për kontratë është i pa përgjegjshëm edhe për faktin se i njëjti është mundur të manipuloj edhe me prodhimet e pjesëveduke ndërruar vendin e origjinës dhe ka vendosu emra te prodhuesve **EU/POLONI**mirëpogjatë hulumtimit e kemi vërejtur se janë prodhime **Kineze** me te cilat ka ofertuar. Kur analizohet lista e përshkrimit te çmimeve te OE të rekomanduar për kontratë vërtetohet një fakt i tillë, mirëpo ne po ju dëshmojmë edhe një herë një gjë të tillë, duke e sqaruar konkretisht pretendimin tonë ankimor.

Këtë edhe ju dëshmojm edhe me FAKTE: Në webfaqen intercars , Artikullin(Pozicioni 84. Radiatori I klimes I jashtmi) dhe **(** Pozicioni 2. Filteri I naftes)**për tëcilin e ka cek që është nga Europa/Polonia, më poshtë mund ta shihni edhe dëshminë që është nga KINA.**

KTT110042
PARAMETERS
CROSS REFERENCES (16)
APPLICATIONS
OTHER NUMBERS (31)
MULTIMEDIA (1)
40.08 EUR
Product details
Kur të klikon këtu shfaqet Origjina e produktit
We recommend:
TecDoc details


Index
KTT110042
Name
Condenser, air cond fitting
Manufacturer
THERMOTEC
Measurement unit
piece
Reporter
Country of origin
China
Print
Cancel


6.93 EUR
Print
Cancel

Nga faktet e me sipërme shihet qarte se OE është i papërgjegjshëm.

AK ka bërë shkelje të nenit 60 duke mos respektuar kriteret e përcaktuara në dosjen e tenderit si kritere kualifikuese duke rekomanduar për kontratë OE e cili nuk është i përgjegjshëm, në këtë rast AK me vetëdije shkel ligjin e prokurimit.

AK ka bërë shkelje të nenit 72 duke kërkuar sqarime nga OE i rekomanduar përkontratë në lidhje me listën e kontratave ku prapë OE nuk ka arritur të dëshmojë se ka kontrata të realizuara po ashtu AK përmes sqarime është munduar te arsyetoje vendimin përmes sqarimeve te cilat nuk janë në harmoni me ligjin.

Me datën: 02.06.2023, pranuam nga Autoriteti Kontraktues - Policia e Kosovës, vendimin mbi refuzimin e kërkesës për shqyrtim. Vendimi i AK-së, përmban konstatime të cilat bien ne kundërshtim me kërkesat e dosjes së tenderit.

Konkretishte autoriteti kontraktues ne vendimin e datës: 02.06.2023, ne faqen Nr. 3, ne pergjigje te pretendimit tonë, i ka listuar të gjitha kontratat e OE të rekomanduar për kotnratë të cilat sipas autoritetit kontraktues janë kontrata valide.

Sqarimi i AK-se:

Ne do të ju sqarojmë për secilën kontratë që është e realizuar/përfunduar gjatë 3 (tri) viteve të fundit (nga data e publikimit te njoftimit për kontrate) jo me pak se 400,000.00€ si në vijim:

1. Furnizim me pjese rezerve dhe mirëmbajtja e makinerisë se rende (bulldozhera) me numër te prokurimi KMDK-19-4022-1-1-1, kontratë kornizë tri vjeçare vlerë prej 394,361.81€ ndërsa vlera e furnizimeve te përfunduara/realizuara është **300,958.78€**
2. Furnizim me pjese për automjete toyota 120 – Policia e Kosovës , ne vlere prej **5,799.97€,**
3. Furnizim me pjese këmbimi për automjete – Posta e Kosovës, ne vlere prej **8,420.07€,**
4. Furnizim me pjese, vajra dhe bateri për automjete – Toverlani, ne vlere prej **45,267.48€**
5. Framework Contract for the supply of automotive spare parts no.6 –EULEX, vlera e realizuar është **20,426.52€,**
6. Furnizim me goma – Komuna e Mitrovicës se Veriut, ne vlere prej **3,000.00€,**
7. Furnizim me goma – Komuna e Zveqanit, ne vlere prej **2,249.96€,**
8. Furnizim me një automjete për nevojat e KMDK, ne vlere prej **29,900.00€**
9. Furnizim me pjese rezerve për makinerin Liebherr - KMDK me numër te prokurimit KMDK-19-887-1-2-1, kontratë kornizë tri vjeçare vlerë prej 29,263.20€ ndërsa vlera e furnizimeve te përfunduara/realizuara është **8,707.20€.**

Të gjitha vlerat e sipër përmendura janë furnizime dhe asnjë shërbim nuk është pranuar.
Ndërsa kontratat tjera qe janë me kompani private dhe me KMDK janë kontrata aktive të pa përfunduara dhe nuk janë marre për bazë.

SQARIM HYRES:

Autoriteti kontraktues - Policia e Kosoves i ka publikuar dy aktivitete te prokurimit:

FURNIZIM ME PJESË PËR AUTOMJETET TOYOTA LAND CRUSER 150

FURNIZIM ME PJESE PER AUTOMJETET SHKODA RAPID-TE

Ne te dy aktivitet e mesipërme autoriteti kontraktues e përdore të njejtën kërkese në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë.

Ne aktivitetin e prokurimit FURNIZIM ME PJESË PËR AUTOMJETET TOYOTA LAND CRUSER 150, AK-ja e eliminon (bashkangjitur me ankes**en** e gjeni vendimin e kërkesës për rishqyrtim të dates: 01.06.2023) OE të rekomanduar për kontratë me arsyetimin se:

Pretendimet se AK ka shkelur nenin 59 të LPP-ës, nuk qëndron pasi AK, sqaron se nuk ka bërë shkelje të këtij neni pasi që vlerësimi i ofertave është bërë në harmoni me Ligjin e Prokurimit Publik, konforme kërkesave në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontrate. Komisioni i vlerësimit ka kërkuar sqarime shtesë për të gjithë ofertuesit dhe brenda afateve kohore ka pranuar sqarimet. Edhe pas sqarime oferta e Juaj nuk i plotëson kriteret e kërkuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë, pasi që ju keni dorëzuar dokumente shtesë mirëpo nuk ka arrit që të ofroj fakte e dëshmi se mbulon kërkesat e AK pasi që referencën me KMDK që keni ofruar/dorëzuar me sqarime shtesë është lëshuar me datë 26/04/2023 nga KMDK, ndërsa ofertat janë dorëzuar me date 18/04/2023 që do të thotë është lëshuar pas datës së dorëzimit të ofertave të AK ndërsa të tjerat nuk e mbulojnë vlerën e kërkuar pasi që kontratat me kompani **private janë kontrata aktive.**
Konform Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë pika 3 citat:
3. Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive. Mbi këtë bazë pretendimi juaj është plotësisht i pa bazuar.

Ndërsa ne aktivitetin e prokurimit FURNIZIM ME PJESE PER AUTOMJETET SHKODA RAPID-të, Kontrata me nr rendor 1 është në rregull dhe sipas kërkesës së dosjes së tenderit.

Sqarimi i mësipërm, u dha vetëm për të dëshmuar se AK-Policia e Kosovës përdorë standarde të dyfishta në vleresime të ofertave dhe diskriminim e hapur që bënë kundërdrejte opetaorëve ekonomik pjesamarrës.

Faktet dhe argumentet:

Sa i përket kontratës me numer rendore 1, titull : Furnizim me pjesë rezervë dhe mirëmbajtje e makinerise së rënde (Bullduzhera), **NUK DUHET TE MERRET FARE PARASYSH,** sepse referenca (edhe sipas autoritetit kontraktues ne vendimin e dates: 01.06.2023) është e lëshuar me date: 26.04.2023, ndërsa hapja e ofertave është bërë me daten: 18.04.2023.

PËRVEQ KËSAJ

Nese i referohemi titullit të këtij aktiviteti te prokurimit: Furnizim me pjesë rezervë dhe **mirembajtje e makinerise ses rende (Bullduzhera),** rezulton që nuk ka të bëjë fare me furnizimin e pjeseve te cilat i kërkon autoriteti kontraktues tek aktiviteti i prokurimit me titull: FURNIZIM ME PJESE PER AUTOMJETET SHKODA RAPID-TË , sepse bëhet fjalë për makineri të natyrave të ndryshme dhe që janë me funksione të ndryshme dhe cfarë është me rëndesi as

për se afërmi nuk janë pjeset e njëjta të shkoda Rapid-të apo cfarëdo lloj makinerie me tonazh me të vogel me ato të bollduzherit. Pra, si operatore ekonomik gjithmon i refereohemi pjeseve te cilat autoriteti kontraktues i paraqet ne paramase dhe fakti që me kontraten e KMDK-së i rekomanduari për kontratë e ka furnizuar me pajisje te BULLDUZHERIT, nuk perkon me natyren e ketij aktiviteti te prokurimit. Edhe sa u perket faturave I rekomanduari per kontrate eshte mundur qe te deshmoje me fatura te furnizimit nga te cilat mund ti shihni fare qart datat e furnizimit te cilat bie ndesh me paragrafin 3 te nenit 72 te LPP-se.

Pra, sic e permendem edhe me larte ne rastin konkret kontrata ne fjale nuk ka te beje me natyren e ketij aktiviteti sepse dallimi eshte esencial ne pajsijet qe do te furnizohet autoritetit kontraktues.

Kontrata me nr rendor nr. 4, e cila eshte njereference me nje operator ekonomik privat - OE Toverlani, nuk i permban as minimumin e te dhenave te percaktuara ne dosje te tenderit. prandaj ne konsiderojme si shkelje esenciale te dispozitave te paragrafit 4 te nenit 59 te LPP-se, sepse ne paragrafin e 4 te nenit 59 te LPP-se, thuhet se Autoriteti kontraktues do ta konsideroj te pergjegjegjshem vetem operatorin ekonomik i cili eshte ne epruthje te plote me kerkesat e dosjes se tenderit dhe te njoftimit per kontrate.

Kjo refence eshte e elshaur me daten 02.02.2020 ndersa aktiviteti i prokurimit eshte publikaur me daten 02.03.2023 pra shifet qart se kjo referenc eshte ma e vjeter se 3 vite dhe ne asnje menyre nuk eshte valdite per ket aktivitet te prokurimit.

Ne rastin konkrete sic u permend edhe me larte autoritetit kontraktues, na diskriminon ne kundershtim me nenin 7 te LPP-se, per faktin se me te njejten kerkese e eliminon OE te rekomanduar per kontrate ndersa ne nje tjeter e rekomandon per kontrate. nga kjo shihet qarte qe diskriminimi i OE-ve, eshte ceshtje te cilen autoriteti kontraktues e perdore haptas.

Poashtu kontrta me numer rendor 9 poashtu ngjashem ka te beje me pajisje te bollduzherit sikurse kontrata me numer 1, qe ska te beje fare fare me pajisjen - automjetin Shkoda rapid, andaj edhe kjo nuk duhet te merret parasysh.

AK ne pergjigjen e kerkeses per rishqyrtim nuk i ka amrrur fare per baze mbi origjinen e prodhusve ku OE thot se jane nga vendi Poloni ndersa shum leht ne internet veretohet se keta prodhues jane nga Kina.

AK nuk i ka marrur per baze pretendimet ankimore tona dhe nuk i ka shqyrtuar ne menyre te drejt duke u mundur te beje anashkalim me qellimin e vetem per te shperblyer me kontrat OE i cili nuk eshte i pergjegjshem.

Duke u bazuar ne sqarimet e dhena me larte, kerojme nga Organi Shqyrtues i Prokurimit ankesen tone ta:

APROVOJE si te bazuar dhe aktivitetin e prokurimit ne fjale ta kthej ne rivleresim.

Shpresojme qe ankesa jonë të Aprovohet e bazuar dhe të merrni vendim meritor për

Rivlerësimin e këtij aktiviteti të prokurimit.

Pretendimet ankimore te parashtruara ne ankesën e deponuar ne OSHP, janë të njëjta.

KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	8.1 & 8.2	**Kerkesa 1 Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme AK-së , se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve të fundit ka qenë në vlerë, se bashku në të tri vitet, prej jo më pak se minimum 500,000.00 €**	**Dëshmi 1 OE duhet te dëshmojë me deklaratat Tatimore Vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës për tri vitet e fundit.**
Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	**a) Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës se njëjte apo të ngjashme gjatë 3 (tri) vitet e fundit (nga data e publikimit te njoftimit për kontrate) jo me pak se 400,000.00 €**	**a) Listën e kontratave të realizuara gjatë tri viteve të fundit (nga data e publikimit të këtij njoftimit për kontrate) e nënshkruar dhe vulosur nga OE. Referencat ose fletët pranimet në kopje të nënshkruar dhe vulosur nga Autoritet për përkatës të cilat duhet të tregojnë, numrin e prokurimit ose kontratës, vlerën e kontratës, datën e nënshkrimit të kontratës, dhe vendin e realizimit të furnizimeve. Vërejtje Asnjë kontrate nuk do te llogaritet nëse nuk është e bashkangjitur referenca pozitive për kryerjen e furnizimeve ose raportet e flete pranimeve te furnizimeve kur furnizimi është bërë për**

			një autoritet publik apo privat në Kosovë ose ne një vend tjetër, për dëshmi duhet te dorëzohen fletëpranimet ose referencat (ne referenca te jete e cekur vlera e furnizimeve, shërbimeve ose punëve) te lëshuara nga autoriteti i tillë
		Kerkesa 1-OE është i obliguar ta beje rregullimin e auomjetit (montimin e pjesëve nen garancion) brenda teritorit të Prishtinës ose një distancë jo ma te largët se 15 kilometra nga Flota Operative bazuar ne rrugën me te afërt tokësore te asfaltuar. OE i jepet mundësia qe te lidhe kontrate me ndonjë Servis i cili gjindet brenda rrezes (15km)	**Deshmi 1 –OE duhet te sjelle Deklarate mbi Lokacioni i servisit (adresa), Flota Operative -Lokacioni i OE. Poqese OE ka objektin e servisit me qira duhet te prezentohet edhe marreveshja mes operatoreve. Marveshja duhet te jete e noterizuar.**
		Kërkesa 3- Operatori ekonomik duhet te posedoje pajise kompjuterike për kryerjen e diagnozës elektronike te automjeteve.OE i jepet mundesia te lidh marreveshje per shfrytezim te paisjes	**Dëshmi 3- Operatori ekonomik duhet te dëshmoj me një dokument (fatur e blerjes) për pronësinë dhe foton e pajisjes kompjuterike për kryerjen e diagnozës elektronike te automjeteve Poqese aparati eshte marre me qira, duhet te deshmohet pronesia e pales se trete me fatur dhe foto**

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Komisioni i vlerësimit pas ekzaminimit, vlerësimit, negocim të ofertave për këtë aktivitet i prokurimit, konstatojmë se për këtë janë pranuar kater(3) oferta, komisioni vlerësues rekomandon si ne vijim: t'i jepet kompanisë "Ideal Shala B.I., sepse i plotës gjitha kriteret e kërkuara në dosje të tenderit si dhe çmimi me i ulet si ofertë e përgjegjshëm.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

Kërkesa përmes eprokurimit e datës 21.06.2023

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **Dyqani i Pavarur Tregtar Autopjesë " Buqa "**

Përgjigje në Pretendimin nr.1

Lidhur me pretendimin e pare qe ka te beje me kërkesën e përshtatshmërisë profesionale 9.1 & 9.2**a) Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës se njëjte apo të ngjashme gjatë 3 (tri) vitet e fundit (nga data e publikimit te njoftimit për kontrate) jo me pak se 400,000.00 €**

Dëshmia: a) Listën e kontratave të realizuara gjatë tri viteve të fundit (nga data e publikimit të këtij njoftimit për kontrate) e nënshkruar dhe vulosur nga OE. Referencat ose fletët pranimet në kopje të nënshkruar dhe vulosur nga Autoritet për përkatës të cilat duhet të tregojnë, numrin e prokurimit ose kontratës, vlerën e kontratës, datën e nënshkrimit të kontratës, dhe vendin e realizimit të furnizimeve. Vërejtje: Asnjë kontrate nuk do te llogaritet nëse nuk është e bashkangjitur referenca pozitive për kryerjen e furnizimeve ose raportet e flete pranimeve te furnizimeve kur furnizimi është bërë për një autoritet publik apo privat në Kosovë ose ne një vend tjetër, për dëshmi duhet te dorëzohen fletëpranimet ose referencat (ne referenca te jete e cekur vlera e furnizimeve, shërbimeve ose punëve) te lëshuara nga autoriteti i tillë

Eksperti shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për kontratë me ofertën e tij ka dorëzuar listën e kontratave në te cilën pjesë e asaj liste është edhe kontrata "Furnizim me pjesë rezervë dhe mirëmbajtja e makinerisë se rëndë (buldozerëve) me nr. KMDK-19-4022-1-1-1 ne vlere **394,361.81 €.**

OE i rekomanduar për kontratë për kontratën në fjalë nuk i kishte bashkangjitur ***"referencat apo fletëpranimet e nënshkruara"*** sikurse është kërkuar me dosjen e tenderit 9.1 & 9.2.

AK-ja me datën 14.04.2023 ka dërguar kërkesë për sqarim ku kërkon sqarime për origjinën e disa produkteve, çmimet dhe ne piken e dytë kërkon dorëzimin e referencave sipas listës se dorëzuar me ofertë me afat te kthimit te përgjigjes deri me 19.04.2023.

OE i dërgon përgjigjet me datën 19.04.2023 ku si dëshmi përfshin urdhëresa pune dhe fatura nga kontrata me nr. KMDK 19 4022 111 si me lartë. OE prapë me datën 02.05.2023 dërgon një komunikim te AK-ja me kontraktuesin ku ne kërkesën për **"dëshmi se çdo gjë ka shkuar ne rregull me kontratën**" e merr një konfirmim përmes emailit se **"kontrata ka shkuar ne rregull"**.

AK-ja ka dërguar prapë kërkesë për sqarim me datën 04.05.2023 me kërkesën e njëjtë për referenca dhe fletëpranime sipas kërkesës se dosjes si me lartë. Afati për përgjigje në kërkesë deri me 05.05.2023.

OE i dërgon përgjigjet me datën 04.05.2023 ku përfshin **"fatura dhe pranime pune"** për kontratën ne fjalë te cilat nuk i kishte dërguar ne kërkesën e datës 14.04.2023.

Eksperti shqyrtues ne baze te kërkesës për sqarim nga AK te datës 19.04.2023 ka kërkuar sqarime nga AK-ja me kërkesën e datës 21.06.2023 ne lidhje me komunikimin e OE te rekomanduar për kontratë si me poshtë:

"Në sqarimet e dhëna nga OE i rekomanduar për kontratë është dorëzuar një email i kërkuar nga zyrtarja e OE A.F për përfaqësuesin e kontratës se realizuar KMDK M.T si dhe përgjigja e te njëjtit. Ju lutem te me ofroni dëshmi se kur është dërguar kërkesa dhe kur është pranuar përgjigja nga M.T, pra me duhen datat e komunikimit."

- AK-ja ne përgjigjen e saj dërgon komunikimin e datës 02.05.2023 te zyrtares se AK-se H.Z dhe përgjigjen e zyrtarit M.T te datës 03.05.2023.

- Për me tepër dëshmia e dërguar nga OE i rekomanduar për kontrate është dërguar pas afatit te kërkesës (02.05.2023) në të cilën nuk janë përfshirë datat e komunikimit.

- Në kërkesën për sqarime janë kërkuar edhe kontratat për disa pozicione. E njëjta nuk është kërkuar për OE Toverlani me referencën prej **45,267.48** te datës 01.08.2021 për te vërtetuar se a është kontratë e përfunduar. AK-ja e ka llogaritur ne listën e kontratave te realizuara.

- Poashtu AK gjatë përllogaritjes se pranimeve nuk i ka marre parasysh liferimit te cilat nuk hyjnë periudhën prej tri vitet e fundit nga data e njoftimit te kontratës.

OE i rekomanduar për kontrate ka dorëzuar fletëpranime te cilat ne kerkese per sqarime i ka emërtuar "pranime pune "si me poshtë:



ALLMAKES GLOBAL SERVICES

Nr. 08115

URDHËR I PUNËS

JOB ORDER

Urdhër i Punës Nr / Job Order NO

GJITHSEJT - TOTAL: (€)

1.

2.

3.

Automjeti i riparuar është pranuar nga klienti:

Vehicle received as repaired and accepted by customer:

Emri / Name:

Nënshkrimi / Signature:

- Eksperti shqyrtues vlerëson se dokumenti i dorëzuar i cili përben 80% te dëshmive sipas nenit 9.1 dhe 9.2 nuk e plotëson kërkesën 9.1 & 9.2 te dosjes se tenderit.

Eksperti shqyrtues vlerëson se gjate kërkesës për sqarime shtesë AK-ja nuk ka vepruar ne përputhje me nenin 59 paragrafi 2 te LPP-se **Ekzaminimi,VlerësimidheKrahasimiiTenderëve,**

Neni69 AftësiaTeknike dhe/oseProfesionale si dhe

1. **Neni72 Dokumentacionidhe informacionishtesë Paragrafi 1** Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë qe të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati te caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës.

3. Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.

Rrjedhimisht eksperti shqyrtues vlerëson se **pretendimi ankimor është i bazuar.**

<u>Përgjigje në Pretendimin nr. 2</u>

Lidhur me pretendimin e OE ankues qe ka te beje me origjinën e produkteve eksperti shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për kontrate me ofertën e tij ka dorëzuar edhe origjinën e produkteve te cilën e ka dorëzuar edhe pas kërkesës për sqarim te tenderit me

datën 02.06.2023.

Ne sqarim ka dorëzuar edhe certifikatën përkatëse nga prodhuesi i cili dëshmon se produktet e prodhuara janë ne përputhje me standardet.

Eksperti shqyrtues vlerëson se te gjitha kompanitë e mëdha botërore sot e kanë linjën e prodhimit ne Kinë duke mos humbur cilësinë dhe brand kështuqë çështja e origjinës dhe kualitetit të produkteve është çështje e rregulluar me kontratë me kushtet e përgjithshme neni 3 dhe kushtet e veçanta neni 16.2.

Prandaj eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi ankimor për këtë pikë **nuk është i bazuar**

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të **APROVOHET SI E BAZUAR**, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në **RIVLERESIM.**

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **POLICIA E KOSOVËS**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **Dyqani i Pavarur Tregtar Autopjesë " Buqa "**

Burim Zeka